



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



Nr. 47/2020
Dt. 12.06.2020

Datë: 12.06.2020

Konform nenit 91 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 6, pika 5 e Rregullores së Punës së KRPP-së, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr. 01/04, të dt. 07.06.2020, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, nxjerrë këtë:

NJOFTIM

Meqenëse situata epidemiologjike në vend konsiderohet me rrezik më të ulët krahasuar me situatën paraprake e konstatuar nga IKSHPK dhe zyra e OBSH-së në Kosovë, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr. 01/04, të dt. 07.06.2020 për aprovimin e Kërkesës së ministrisë së Shëndetësisë për shfuqizimin e pikave 6.1, 6.2, 6.3 dhe 6.4 të Vendimit të Qeverisë Nr.02/38 të datës 31 Maj 2020, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nga data e këtij Njoftimi **shfuqizon Njoftimet e datës 16.03.2020 dhe datës 30.03.2020, si dhe Njoftimet me Nr. 40/2020, 41/2020 dhe 42/2020 të datës 21.04.2020** të cilat kanë pasur për qëllim lehtësimin e procedurave të tenderimit në situatën e krijuar si rezultat i pandemisë COVID-19.

Nga data e publikimit të këtij Njoftimi, Autoritetet kontraktuese janë përgjegjëse për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj.

Osman VISHAJ

Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

